



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Nr. 1264/prot.

5

Tiranë më 10.10 2018

**VENDIM**

**Nr. 55, datë 10.10.2018**

**PËR**

**URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënavë personale" i ndryshuar,

**KONSTATOVA SE:**

Ankuesi, z. ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënavë Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") Formularin e Ankesës nr. 1264 Prot., datë 06.08.2018, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*", kundër Autoritetit Publik "Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Ankuesi në cilësinë e kërkuesit, nëpërmjet kërkësës së datës 03.07.2018 ka kërkuar nga Autoriteti Publik t'i vihet në dispozicion dokumentacioni dhe informacioni i disponueshëm në lidhje me:

- Të dhënat statistikore për të gjitha investimet e kryera gjatë 10 viteve të fundit në infrastrukturën e pajisjeve spitalore, pajisjeve mjekësore dhe laboratorike në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë (pajisje spitalore elektro - mjekësore, pajisje laboratorike diagnostikuese, pajisje spitalore kirurgjikale, pajisje të konsumueshme spitalore me një përdorim dhe sterilizuese shumëpërdorishme, pajisje spitalore për arredimin e sallave të urgjencës, sallave të reanimacioneve, sallave të operacioneve, sallave të vizitave e dhomave të pacientëve dhe të gjitha llojeve të tjera të pajisjeve spitalore që shërbejnë për diagnostikimin dhe kurimin e pacientëve), ku për çdo investim të pasqyrohen: lloji i pajisjeve spitalore, kostot financiare, burimi i financimit të investimit dhe subjekti fitues i tenderit.*

- Të dhënët statistikore për të gjitha investimet e kryera gjatë 10 viteve të fundit në infrastrukturën e pajisjeve spitalore, pajisjeve mjekësore dhe laboratorike në Spitalin Universitar të Traumës (Spitali Ushtarak), Tiranë, ku për çdo investim të pasqyrohen: lloji i pajisjeve spitalore, kostot financiare, burimi i financimit të investimit dhe subjekti fitues i tenderit.
- Të dhënët statistikore për të gjitha investimet e kryera gjatë 10 viteve të fundit në infrastrukturën e pajisjeve spitalore, pajisjeve mjekësore dhe laboratorike në Spitalin Universitar OBS- GJIN “Mbretëresha Geraldinë”, Tiranë, ku për çdo investim të pasqyrohen: lloji i pajisjeve spitalore, kostot financiare, burimi i financimit të investimit dhe subjekti fitues i tenderit.
- Të dhënët statistikore për të gjitha investimet e kryera gjatë 10 viteve të fundit në infrastrukturën e pajisjeve spitalore, pajisjeve mjekësore dhe laboratorike në Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, ku për çdo investim të pasqyrohen: lloji i pajisjeve spitalore, kostot financiare, burimi i financimit të investimit dhe subjekti fitues i tenderit.
- Të dhënët statistikore për të gjitha investimet e kryera gjatë 10 viteve të fundit në infrastrukturën e pajisjeve spitalore, pajisjeve mjekësore dhe laboratorike në Spitalin S.U.O.GJ “Koço Gliozeni” Tiranë, ku për çdo investim të pasqyrohen: lloji i pajisjeve spitalore, kostot financiare, burimi i financimit të investimit dhe subjekti fitues i tenderit.
- Të dhënët statistikore për të gjitha investimet e kryera gjatë 10 viteve të fundit në infrastrukturën e pajisjeve spitalore, pajisjeve mjekësore dhe laboratorike në të gjitha spitalet rajonale në Republikën e Shqipërisë duke specifikuar secilin spital rajonal, ku për çdo investim të pasqyrohen: lloji i pajisjeve spitalore, kostot financiare, burimi i financimit të investimit dhe subjekti fitues i tenderit.
- Të dhënët statistikore për të gjitha investimet e kryera gjatë 10 viteve të fundit në infrastrukturën e pajisjeve spitalore, pajisjeve mjekësore dhe laboratorike në të gjitha spitalet bashkiakë në Republikën e Shqipërisë duke specifikuar secilin spital bashkiak (pajisje spitalore elekro - mjekësore, pajisje laboratorike diagnostikuese, pajisje spitalore kirurgjikale, pajisje të konsumueshme spitalore me një përdorim dhe sterilizuese shumëpërdorimshe, pajisje spitalore për arredimin e sallave të urgjencës, sallave të reanimacioneve, sallave të operacioneve, sallave të vizitave e dhomave të pacientëve dhe të gjitha llojeve të tjera të pajisjeve spitalore që shërbejnë për diagnostikimin dhe kurimin e pacientëve), ku për çdo investim të pasqyrohen: lloji i pajisjeve spitalore, kostot financiare, burimi i financimit të investimit dhe subjekti fitues i tenderit.
- Të dhënët statistikore për të gjitha investimet e kryera gjatë 10 viteve të fundit në të gjitha qendrat spitalore shëndetësore dhe ambulancë në Republikën e Shqipërisë, duke specifikuar secilën qendër shëndetësore dhe ambulancë, ku për çdo investim të pasqyrohen: lloji i pajisjeve spitalore, kostot financiare, burimi i financimit të investimit dhe subjekti fitues i tenderit.
- Të dhënët statistikore për të gjitha investimet e kryera gjatë 10 viteve të fundit në infrastrukturën e pajisjeve spitalore, pajisjeve mjekësore dhe laboratorike në të gjitha poli-klinikat në Republikën e Shqipërisë, duke specifikuar secilën qendër shëndetësore dhe ambulancë (pajisje spitalore elekro - mjekësore, pajisje

*laboratorike diagnostikuese, pajisje spitalore kirurgjikale, pajisje të konsumueshme spitalore me një përdorim dhe sterilizuese shumëpërdorimëshe, pajisje spitalore për arredimin e sallave të urgjencës, sallave të reanimacioneve, sallave të operacioneve, sallave të vizitave e dhomave të pacientëve dhe të gjitha llojeve të tjera të pajisjeve spitalore që shërbejnë për diagnostikimin dhe kurimin e pacientëve), ku për çdo investim të pasqyrohen: lloji i pajisjeve spitalore, kostot financiare, burimi i financimit të investimit dhe subjekti fitues i tenderit.*

- *Të dhënrat statistikore për të gjitha investimet e kryera gjatë 10 viteve të fundit në infrastrukturën e pajisjeve spitalore, pajisjeve mjekësore dhe laboratorike në të gjitha poli-klinikat në Republikën e Shqipërisë, duke specifikuar secilën prej poliklinikave, ku për çdo investim të pasqyrohen: lloji i pajisjeve spitalore, kostot financiare, burimi i financimit të investimit dhe subjekti fitues i tenderit.*
- *Të dhënrat statistikore për të gjitha investimet e kryera gjatë 10 viteve të fundit në infrastrukturën e pajisjeve spitalore, pajisjeve mjekësore dhe laboratorike në spitalet psikiatrike, Vlorë, Shkodër dhe Elbasan, ku për çdo investim të pasqyrohen: lloji i pajisjeve spitalore, kostot financiare, burimi i financimit të investimit dhe subjekti fitues i tenderit.*
- *Të dhënrat statistikore për të gjitha investimet e kryera gjatë 10 viteve të fundit në infrastrukturën e pajisjeve spitalore, pajisjeve mjekësore dhe laboratorike në bankat e gjakut në Republikën e Shqipërisë, ku për çdo investim të pasqyrohen: lloji i pajisjeve spitalore, kostot financiare, burimi i financimit të investimit dhe subjekti fitues i tenderit.*
- *Të dhënrat statistikore për të gjitha investimet e kryera gjatë 10 viteve të fundit në infrastrukturën e pajisjeve spitalore, pajisjeve mjekësore dhe laboratorike në të gjithë drejtoret e shëndetit publik në Republikën, ku për çdo investim të pasqyrohen: lloji i pajisjeve spitalore, kostot financiare, burimi i financimit të investimit dhe subjekti fitues i tenderit.*
- *Të dhënrat statistikore për të gjitha investimet e kryera gjatë 10 viteve të fundit në infrastrukturën e pajisjeve spitalore, pajisjeve mjekësore dhe laboratorike në të gjithë laboratorët mjekësorë shtetërorë në Republikën e Shqipërisë, ku për çdo investim të pasqyrohen: lloji i pajisjeve spitalore, kostot financiare, burimi i financimit të investimit dhe subjekti fitues i tenderit.*
- *Të dhënrat statistikore për të gjitha investimet e kryera gjatë 10 viteve të fundit në infrastrukturën e pajisjeve laboratorike në Institutin e Shëndetit Publik ku për çdo investim të pasqyrohen: lloji i pajisjeve spitalore, kostot financiare, burimi i financimit të investimit dhe subjekti fitues i tenderit.*
- *Të dhënrat statistikore për të gjitha investimet e kryera gjatë 10 viteve të fundit në infrastrukturën e pajisjeve laboratorike dhe elementeve të tjera laboratorikë në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut në Tiranë, ku për çdo investim të pasqyrohen: lloji i pajisjeve spitalore, kostot financiare, burimi i financimit të investimit dhe subjekti fitues i tenderit.*
- *Të dhënrat statistikore për të gjitha investimet e kryera gjatë 10 viteve të fundit në infrastrukturën e pajisjeve spitalore për arredim të ambienteve të Qendrës Kombëtare të Mirërritjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve dhe Investimet*

*në pajisjet spitalore, ku për çdo investim të pasqyrohen: lloji i pajisjeve spitalore, kostot financiare, burimi i financimit të investimit dhe subjekti fitues i tenderit.*

- *Të dhënrat statistikore për të gjitha investimet e kryera gjatë 10 viteve të fundit në infrastrukturën e pajisjeve spitalore, pajisjeve mjekësore dhe laboratorike në Klinikën Stomatologjike Universitare Tiranë, ku për çdo investim të pasqyrohen: lloji i pajisjeve spitalore, kostot financiare, burimi i financimit të investimit dhe subjekti fitues i tenderit.*
- *Të dhënrat statistikore për të gjitha investimet e kryera gjatë 10 viteve të fundit në infrastrukturën e pajisjeve spitalore e mjekësore në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, ku për çdo investim të pasqyrohen: lloji i pajisjeve spitalore, kostot financiare, burimi i financimit të investimit dhe subjekti fitues i tenderit.*
- *Të dhënrat statistikore për të gjitha investimet e kryera gjatë 10 viteve të fundit në infrastrukturën e pajisjeve spitalore, mjekësore dhe laboratorike në Oficinën Elektro Mjekësore, ku për çdo investim të pasqyrohen: lloji i pajisjeve spitalore, kostot financiare, burimi i financimit të investimit dhe subjekti fitues i tenderit.*
- *Të dhënrat statistikore për të gjitha investimet e kryera gjatë 10 viteve të fundit në infrastrukturën e pajisjeve spitalore, mjekësore dhe laboratorike në Klinikën e Shërbimeve Shëndetësore Qeveritare, ku për çdo investim të pasqyrohen: lloji i pajisjeve spitalore, kostot financiare, burimi i financimit të investimit dhe subjekti fitues i tenderit.*
- *Të dhënrat statistikore për të gjitha investimet e kryera gjatë 10 viteve të fundit në infrastrukturën e pajisjeve spitalore, mjekësore dhe laboratorike në: Spitalet Rajonale, spitalet bashkiake, Qendrat Shëndetësore, bankave të gjakut, Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza"; Spitalit Universitar të Traumës (Spitali Ushtarak), Tiranë; Spitalit Universitar OBS-GJIN "Mbretëresha Geraldinë" Tiranë; Spitalit Universitar "Shefqet Ndraqi", Tiranë; Spitalit S.U.O.Gj "Koço Gllozheni", Tiranë; të spitaleve psikiatrike, Vlorë, Shkodër dhe Elbasan; të Klinikës Stomatologjike Universitare në Tiranë; të Njësisë së Transportit Mjekësor me Helikopter; të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore; të Oficinës Elektro Mjekësore dhe të Klinikës së Shërbimeve Shëndetësore Qeveritare.*

Lidhur me sa kërkon në kërkesën e sipërcituar z. , pretendon se nuk ka marrë përgjigje nga ana e Autoritetit Publik dhe për këtë arsyе është drejtuar me ankesë pranë Zyrës së Komisionerit.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, me shkresën nr. 1264/1 Prot., datë 07.08.2018 ka kërkuar nga Autoriteti Publik rivlerësimin e dhënies së informacionit brenda datës 14.08.2018. Detyrimi për informim nuk rezulton i përbushur, megjithëse ka kaluar afati i vendosur nga Zyra e Komisionerit. Për këtë arsyë ankuesi ka vijuar ankimin me nr. 1264/2 Prot., datë 20.09.2018 pranë Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Zyra e Komisionerit, me Urdhrin Nr.245, datë 08.10.2018, vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik, me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Gjatë inspektimit u konstatua se kërkesa e Z. është depozituar pranë Autoritetit Publik nëpërmjet shërbimit postar, vërtetuar kjo nga receta postare nr. 9301 datë 03.07.2018 dhe është regjistruar me nr. H- 63 Prot., datë 05.07.2018. Nga verifikimi i kryer nga koordinatori në regjistrin e protokollit të institucionit rezultoi se kërkesa e Z. i ka kaluar për trajtim Drejtorisë së Financës, së Autoritetit Publik.

Duke qenë se kjo drejtori nuk ka përgatitur një kthim përgjigje brenda afatit të përcaktuar në ligj, me iniciativën e tij, koordinatori i së drejtës për informim, (i cili është vënë në dijeni për çështjen nga komunikimi me Zyrën e Komisionerit), ka dërguar një email më datë 23.08.2018, ku sqaron kërkuesin se informacioni administrohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, si institucioni kompetent për këtë informacion. Nga konsultimi i legjisacionit të zbatueshëm Komisioneri vlerëson se argumenti i dhënë nga Autoriteti Publik nuk qendron pasi Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, në zbatim të ligjit nr. 10383 datë 24.02.2018 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, nuk ka për detyrë kryerjen e investimeve në përmirësimin e infrastrukturës spitalore, por financimin e shërbimeve shëndetësore për personat e siguruar në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Për pasojë Fondi disponon informacion vetëm për buxhetet e akorduara dhe të shpenzuara nga çdo spital i kontraktuar për ofrimin e shërbimeve shëndetësore ndaj personave të siguruar, gjatë 10 viteve të fundit.

Ky fakt vertetohet dhe me shkresën nr. 3324 Prot., datë 30.07.2018, me të cilën Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për të njëjtën kërkeshë për informacion (me të njëtin objekt), të Z. e ka deleguar për ndjekje nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si autoriteti që administrojn informacion të detajuar sipas kërkeshës për informim.

Më tej, me anë të një tjetër emaili, me datë 21.09.2018, koordinatori iu është drejtuar institucioneve të vartësish (spitaleve), me kërkeshën që të përgatisin dhe dërgojnë informacionin e kërkuar pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në mënyrë që kjo e fundit ta vendoë në dispozicion kërkuesin. Në të njëjtën kohë koordinatori ka kërkuar nga zyra e Komisionerit zgjatjen e afatit kohor për përbushjen e detyrimit për informim ndaj kërkuesit.

Bazuar në nenin 15 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Autoriteti Publik, trajton kërkeshën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përvèç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe. Rezulton se aktualisht Autoriteti Publik nuk ka përbushur detyrimin për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Nga shqyrtimi i çështjes rezulton se informacioni i kërkuar nga Z. përbush kërkeshat e pikës 2 të nenit 2 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit “informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo

*nga Autoriteti Publik*". Për sa më sipër, nga ana e Autoritetit Publik duhet të procedohet me vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Ligji për të Drejtën e Informimit ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike. Si rrjedhojë, duke qenë se informacioni që kërkohet është informacion publik atëherë dhe dhënia e tij është një detyrim ligjor që do të përbushi kërkësen për informim dhe do të rrisë ndjeshëm transparencën.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, "Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përbajtjen e dokumentacionit". E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njëriut, e parashikuar në nenin 23 te Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënieς, si një shtyllë tjeter themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve. Në këto kushte, në lidhje me ankimin e z. ndaj Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se, duke pasur parasysh sa është parashtruar më sipër, ankimi është bazuar në ligj dhe si i tillë duhet pranuar.

PĒR KĒTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës I të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

## VENDOSA:

1. Pranimin e ankimit nr. 1264/2 Prot., datë 20.09.2018 të z. , kundër Autoritetit Publik “Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënien informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
  2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kerkuar sipas kërkesës për informacion të datës 03.07.2018, brenda datës 17.10.2018.
  3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
  4. Ky vendim u shpall sot në datë 10.10.2018.

## KOMISIONERI

Besnik Dervishi

